



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.13, datë 5.2.2007

**PËR
EMËRTIMIN E NJË RRUGE TË PAEMËRTUAR
NË TËRRITORIN E NJËSISË BASHKIAKE NR.5**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 8, paragrafi VII, neni 32, gërma “II”, Ligjit Nr.8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës” neni 8, pika II, dhe Ligjit Nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë emërtimin e një rruge në Njësinë Bashkiake Nr.5, si vijon:

Rruga e të Dashuruarve – Rruga fillon nga rruga “Abdyl Frashëri” deri tek teatri veror i Liqenit.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI